



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr.2/2018(JR),

Tiranë, 18.02 2018

SHPLLJE

E

NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e hënë, në datën **10.09.2018, ora 10:00**, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja Nr.2/2018(JR), datë 17.04.2018, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit nr. 5, datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Zonjën Mirela Fana. Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjykses	Natasha Mulaj
Relator i Çështjes	Rezarta Schuetz
Anëtar	Albana Shtylla
Anëtar	Ardian Hajdari
Anëtar	Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460/5 të Kodit të Procedurës Civile kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjyqimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Bashkëlidhur këtij njoftimi publik komunikohet vendimi nr. 5, datë 23.03.2018 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit znj. Mirela Fana, si dhe ankimi i Komisionerit Publik, kundër vendimit nr. 5, datë 23.03.2018.

**KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR
Natasha Mulaj**

**RELATORI I ÇËSHTJES
GJYQTAR
Rezarta Schuetz**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr.2/2018(JR)

Tiranë, më 18.07.2018

**SHPLLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e hënë, në datën **10.09.2018, ora 10:00**, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja nr. 2/2018(JR), datë 17.04.2018, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit nr. 5, datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit znj. Mirela Fana.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3, Tiranë.

Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesues i Trupit Gjykses	Natasha Mulaj
Relator i Çështjes	Rezarta Schuetz
Anëtar	Albana Shtylla
Anëtar	Ardian Hajdari
Anëtar	Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460/5 të K.Pr.Civile kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**KRYESUESI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTAR
Natasha Mulaj**

**RELATORI I ÇËSHTJES
GJYQTAR
Rezarta Schuetz**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 5 VENDIMI

Tiranë, më 23.03.2018

VENDIM

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesues
Roland Ilia	Relator
Genta Tafa (Bungo)	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore Ina Serjanaj;
pas shortimit të shpërndarjes së çështjes dhe caktimit të kryesuesit dhe relatorit, sot, në datën 23.03.2018, ora 15:00, në sallën nr.1 të selisë së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

Znj. Mirela Fana - gjyqtare pranë Gjykatës së Lartë

BAZA LIGJORE : Neni 179/b pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 14, 56 dhe 57, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Arsyet për pushimin e procesit të rivlerësimit:

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Mirela Fana ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Lartë.

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Mirela Fana ka dhënë dorëheqjen nga detyra që ushtronte, duke e paraqitur këtë dorëheqje, me shkrim, pranë Presidentit të Republikës, i cili e ka publikuar këtë fakt në faqen zyrtare të institucionit.

Nëpërmjet shkresës nr.688/1 prot., datë 19.03.2018, Presidenti i Republikës ka njoftuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit Znj. Mirela Fana në datën 30.01.2017, protokolluar nga ana e Institucionit të Presidentit të Republikës nr. 7/M prot., po më datë 30.01.2017.

Neni 56 i ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë" ka parashikuar mundësinë e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit si vijon:

"1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".

Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3¹, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës së botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 23.09.2016, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin² dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim³, ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë" hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë deri në datën 25.10.2016. Në datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.01.2017. Si rezultat afati 3-mujor, parashikuar nga neni 56, ka përfunduar në datën 31 mars 2017.

Paraqitja e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit brenda këtij afati, sjell si pasojë pushimin e procedurës së rivlerësimit, duke i dhënë këtij subjekti të drejtat e parashikuara në pikën 2, të nenit 56, të ligjit nr. 84/2016.

¹Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij.

Ligji quhet i shpallur, në qoftë se Presidenti i Republikës nuk ushtron të drejtat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe në paragrafin 1, të nenit 85. Ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.

²Pas miratimit nga Parlamenti në datën 22 korrik 2016, dhe kalimit të afatit 20-ditor, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.2016, mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese vendosi pezullimin e zbatimit ligjit nr.84/2016 dhe kërkimin e *amicus curia* nga Komisioni i Venecias në lidhje me pajtueshmërinë e tij me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

³ Në datën 18.01.2017, me vendimin nr.2, Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 56 dhe 57, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar të Znj. Mirela Fana, gjyqtare pranë Gjykatës së Lartë, është pushuar.

Ky vendim u njoftohet Znj. Mirela Fana, Komisionerëve Publikë dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Ankimi kundër këtij vendimi bëhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

XHENSILA PINE

Kryesues



ROLAND ILIA

Relator

GENTA Tafa (BUNGO)

Anëtar

Ky vendim shpallet në datën 23.03.2018.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

VENDIM

Nr. 5/1, datë 27.4.2018

“Për pranimin e ankimit”

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesues
Roland Ilia	Relator
Genta Tafa (Bungo)	Anëtar

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore Ina Serjanaj, në Tiranë, sot, më 27.04.2018, në dhomë këshillimi, mori në shqyrtim çështjen, e cila i përket:

Ankimuesi: Komisioneri Publik z. Florian Ballhysa.

Objekti: Shqyrtimi i ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik z. Florian Ballhysa kundër vendimit nr.5 datë 23.3.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Mirela Fana.

Baza ligjore: Neni 44 e vijues të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi mori në shqyrtim aktet shkresore në dhomë këshillimi, pa pranimin e palëve,

VËREN SE:

1. Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit mori në shqyrtim ankimin e paraqitur nga ankimuesi Komisioneri Publik Z. Florian Ballhysa kundër vendimit nr. 5 datë 23.3.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit znj. Mirela Fana.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i është drejtuar Institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë me shkresën nr. 2372 prot., datë 7.3.2018 lidhur me subjektet



e rivlerësimit, të cilët në zbatim të nenit 56, të ligjit nr. 84/2016, kanë dhënë dorëheqjen dhe që është publikuar nga institucioni i Presidentit në faqen zyrtare.

Me shkresën nr. 688/1 prot., datë 19.3.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. 2372/2 prot., datë 19.3.2018, institucioni i Presidentit të Republikës ka informuar Komisionin mbi listën e subjekteve të dorëhequra, midis të cilëve edhe znj. Mirela Fana.

3. Me vendimin nr.16, datë 7.3.2018 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka ngritur trupën gjykuese të përbërë nga Xhensila Pine, Roland Ilia, Genta Tafa (Bungo), e cila do të vendosë për dorëheqjet e subjekteve të rivlerësimit.
4. Pas shqyrtimit mbi bazë dokumentesh, trupa gjykuese e shortuar, pasi caktoi për çështjen në fjalë relator Roland Ilia dhe kryesues Xhensila Pine, bazuar në nenet 14, 56 dhe 57 të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; vendimin nr. 2, datë 18.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese, ka vendosur:
 - Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Mirela Fana është pushuar.
 - Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit znj. Mirela Fana, Komisionerëve Publikë dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
 - Kundër këtij ankimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit."
5. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim, pranueshmëria apo jo e të cilit përbën objektin e këtij gjykimi.
6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vlerëson se, ankimi duhet të pranohet të shqyrtohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit për arsyet si në vijim:
 - 6.1 **Së pari**, ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor 15 ditor nga e nesërmbja e njoftimit të vendimit të arsyetuar nga ana e Komisionit. Pra, afati prej 15 ditësh nga e nesërmbja e njoftimit të vendimit është respektuar në rastin konkret nga ankimuesi, Komisioneri Publik z. Florian Ballhysa. Vendimi i Komisionit nr. 5 datë 23.3.2018, i është njoftuar Komisionerit Publik më datë 28.3.2018 dhe ankimi i Komisionerit Publik është depozituar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me shkresën nr. 10/1 prot., datë 13.4.2018.
 - 6.2 **Së dyti**, ankimi nuk përmbante të meta nga ato të parashikuara në nenin 46 të ligjit 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar;
 - 6.3 **Së treti**, subjekti i cili ka depozituar ankimimin ka legjitimitet procedural për të paraqitur këtë ankim në përputhje me nenin C, pika 2, nenin F, pika 2, të Aneksit të

Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1, e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në këto rrethana, trupa gjykuese vlerëson se, ankimi me **nr. 10/1 Prot., datë 13.4.2018**, i protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në datë 13.4.2018, me nr. 3400 Prot., i depozituar nga ankimuesi, Komisioneri Publik, Z. Florian Ballhysa, duhet të pranohet për t’u shqyrtuar nga Kolegji i Posaçëm Apeli, pasi plotëson të gjitha kriteret formale të parashikuara në ligj.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 45, 46 dhe 48 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 63, pika 1, e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Pranimin e ankimit, duke urdhëruar zyrën e protokollit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të dërgojë ankimin së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, aktet e komunikimit të ankimit si dhe dosjen e gjykimin pranë Kolegjit të Posaçëm të Apeli.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE


Xhensila Pine

Kryesues




Roland Ilia

Relator




Sekretare gjyqësore:

Ira Serjanaj



Genta Tafa (Bungo)


Anëtar




U shpall në Tiranë, në datë 27.04.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 10/1 prot.

Tiranë, 13.4. 2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik Florian Ballhysa kundër vendimit nr.05, datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Mirela Fana.
- Baza Ligjore:** Neni 179/b, pika 5 i Kushtetutës, Neni C, pika 2, Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i Ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese.
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Të nderuar zonja/zotërinj gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH", në datë 29.03.2018 është njoftuar Vendimi nr.05 datë 23.03.2018, nr.2712 prot., i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit zonjën Mirela Fana, anëtare e Gjykatës së Lartë i Republikës së Shqipërisë.


Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C pika 2, Nenit F pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63 pika 1 e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15 ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj Vendimit nr.05 datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Rezulton se znj. Mirela Fana me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 6133, datë 14.04.2009 është emëruar në detyrën e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Me vendimin nr.248,

datë 23.04.2009, Kuvendi i Shqipërisë ka dhënë pëlqimin për emërimin e zonjës Mirela Fana në këtë detyrë.

38


2. Në datën 30.01.2017 anëtarja e Gjykatës së Lartë znj. Mirela Fana, ka paraqitur pranë Presidentit të Republikës së Shqipërisë kërkesën për dorëheqjen nga funksioni, si dhe ka vënë në dijeni Kryetarin e Gjykatës së Lartë. Nga përmbajtja e aktit, rezulton se znj. Mirela Fana në kërkesën për dorëheqje i referohet mandatis të gjyqtarit pranë Gjykatës së Lartë dhe anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke parashtruar se *"...bazuar në nenin 56 të ligjit nr.84/2016 paraqes dorëheqjen time nga këto funksione. Shkaku i kësaj dorëheqje është vazhdimi studimeve të thelluara akademike"*.

3. Presidenti i Republikës në zbatim të nenit 56, pika 1 e ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ka bërë publikimin e dorëheqjes në faqen zyrtare të institucionit.

4. Trupa gjyqësore e Gjykatës së Lartë, mbështetur në kërkesat e nenit 139, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, rezulton të ketë marrë vendimin nr.01, datë 31.01.2017, për deklarimin e mbarimit të mandatis si anëtare e Gjykatës së Lartë të gjyqtarës Mirela Fana.


5. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pas korrespondencës me institucionin e Presidentit të Republikës (Sekretari i Përgjithshëm) dhe informacionit të dërguar prej këtij të fundit *"lidhur me subjektet e rivlerësimit që kanë dhënë dorëheqjen në zbatim të nenit 56 të ligjit 84/2016 pranë Presidentit të Republikës"*, ka vijuar procedurën e rivlerësimit kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit zj. Mirela Fana, mbi bazën e shortit të hedhur në datë 23.03.2018.

6. Rezulton se mbi këtë bazë dokumentash, trupa gjyqësore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka konkluduar procedurat me vendimmarrje, në lidhje me dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit znj. Mirela Fana.

II. Vendimi dhe arsyetimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

7. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr.5, datë 23.03.2018, ka vendosur: *"-Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar të, Znj.Mirela Fana, gjyqtare pranë Gjykatës së Lartë, është pushuar.*

-Ky vendim u njoftohet zj.Mirela Fana, Komisionerëve Publikë dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.



-Ankimi kundër këtij vendimi bëhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

7.1 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në vendimin e mësipërm, konstaton faktin se znj. Mirela Fana ka paraqitur dorëheqjen me shkrim në datë 30.01.2017 para Presidentit të Republikës, e cila është publikuar në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni.

7.2 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në pjesën arsyetuese të vendimit të tij ka vlerësuar se paraqitja i) e dorëheqjes nga detyra që mbante subjekti i rivlerësimit dhe ii) respektimi i afatit ligjor të parashikuar, jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit nr 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” janë fakte juridike të mjaftueshme, për të legjitimuar vendimarrjen e këtij Komisioni duke disponuar me pushimin e procedurës së rivlerësimit dhe citimin në pjesën arsyetuese të vendimit përfitimin e pagesës kalimtare sipas ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, sipas nenit 56 të ligjit 84/2016,


7.3 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në vijim të arsyetimit ka marrë në analizë hyrjen në fuqi të ligjit me qëllim llogaritjen e afatit ligjor për paraqitjen e dorëheqjes dhe me të drejtë konkludon se *afati 3-mujor, parashikuar nga neni 56, ka përfunduar në datën 31 mars 2017.*

III. Shkaqet e ankimit.

III.A

8. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në raport me ecurinë e mëtejshme të procesit të rivlerësimit, në rastin konkret duhej të argumentonte në mënyrë shteruese natyrën specifike të statusit që gëzon subjekti konkret i rivlerësimit, bazuar në administrimin e plotë të akteve dhe dokumentacionit që lidhen me dorëheqjen, efektet ligjore shkak-pasojë të paraqitjes së saj, pasi konstatohet se dorëheqja kufizohet vetëm në formën e shprehjes së vullnetit të subjektit të rivlerësimit për heqjen dorë nga mandati i anëtarit të Gjykatës së Lartë.

9. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit e ka mbështetur arsyetimin e vendimit vetëm në faktin e paraqitjes së dorëheqjes së subjektit duke e konsideruar atë si të mjaftueshme për të konkluduar me vendimarrjen e tij për deklarimin e pushimit të procedurës së rivlerësimit. Konstatohet se në vendimin e tij, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk ka kryer një analizë dhe vlerësim tërësor të të gjitha dispozitave *materiale dhe proceduriale* që lidhen me




procedurën dhe vendimmarrjen e organeve kushtetuese përkatëse në rastet e shprehjes së njëanshme të vullnetit për t'u dorëhequr nga subjekti i rivlerësimit.

10. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, fillimisht do të duhej që të analizonte nëse znj. Mirela Fana ka dhënë dorëheqjen nga një funksion (si anëtare e Gjykatës së Lartë) apo edhe nga statusi i saj si magjistrat/gjyqtare. Kjo analizë është e domosdoshme pasi subjekti përfitoi ipso lege nga dispozita e pikës 10 të nenit 179 të Kushtetutës dhe nga dispozita kalimtare e ligjit nr.96/2016, neni 164/b, i cili shprehet se “1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Referuar kësaj dispozite, ligjvënësi i ka njohur subjektit, statusin e magjistratit, vijueshmëria e të cilit varej nga kalimi apo jo i procesit të rivlerësimit kalimtar. Gëzimi i statusit të magjistratit në rastin konkret nga subjekti, gjën materializim edhe nga përmbajtja e pikës 1, të nenit 161, të ligjit nr.96/2016, ku parashikohet se: “Gjyqtari në detyrë i Gjykatës së Lartë do të konsiderohet magjistrat, sipas këtij ligji.”

11. Vlerësojmë se, situata ligjore e subjektit nuk është kualifikuar drejtë pasi vendimarrja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është rrjedhojë e kuptimit të gabuar nga ana e këtij organi të situatës juridike sipas të cilit mbarimi i mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartës për shkak dorëheqje sipas pikës 1/c të nenit 139 të Kushtetutës konsiderohet se barazohet me dorëheqjen nga detyra, sipas parashikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

12. Për sqarimin e kësaj situatë ligjore specifike, do të ishte i nevojshëm një hetim administrativ i plotë dhe një arsyetim ligjor shterues. Në arsyetimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk rezulton të jetë identifikuar dhe argumentuar zbatimi i dispozitave përkatëse kushtetuese dhe ligjore, d.m.th argumentimi i lidhjes shkak-pasojë mes deklarimit të mbarimit të mandatit të subjektit të rivlerësimit me vendim të Trupës të Gjykatës së Lartë, dhe zbatimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, për ndalimin e emërimit të subjektit të dorëhequr/magjistrat, për një periudhë 15 vjeçare.

13. Në vazhdim të argumentit të mësipërm, çmojmë se mbarimi i mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet dorëheqjes, nuk passjell humbjen e statusit magjistrat. Në vlerësimin tonë, një magjistrat që jep dorëheqjen nga mandati si anëtar i Gjykatës së Lartë, vazhdon të gëzojë statusin e magjistratit, duke përfutur të gjitha të drejtat që ky status garanton. Pra, në rrethanat konkrete, subjekti vazhdon të gëzojë statusin e magjistratit dhe është objekt i veprimit të nenit 179/b pika 3 e Kushtetutës.



41

14. Në referencë të kësaj analize sistematike kushtetuese dhe ligjore, rezulton se për subjektin e rivlerësimit znj Mirela Fana ka vendim për mbarimin e mandatit si anëtar Gjykatës së Lartë, por nuk ka akt (vendim) që të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes, në zbatim të nenit G të Kushtetutës.

15. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në rrethana të njëjta, në vendimet e tij nr.8, datë 23.03.2018 dhe nr.10, datë 23.03.2018, përpara se të dispononte për pushimin e procesit të rivlerësimit, për subjekte magjistrat/gjyqtar, ka administruar dhe arsyetuar vendimmarrjen e tij mbi vendimin e organit kompetent kushtetues, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka formalizuar dorëheqjen e magjistratit nga statusi i magjistratit në bazë të nenit 160 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

16. 18.Po ashtu, për analogji, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në vendimin nr.11 datë 10.04.2018, përpara se të dispononte për pushimin e procesit të rivlerësimit, për subjektin E.B., magjistrat/prokuror, ka administruar dhe arsyetuar vendimmarrjen e tij mbi vendimin e organit kompetent kushtetues (vendim nr.85 datë 15.03.2018 i Prokurorit të Përgjithshëm), që ka pranuar dorëheqjen e subjektit dhe ka vendosur mbarimin e emërimit të prokurorit, si organi kompetent në bazë të nenit 160, pika 2 e ligjit nr.96/2016.

17. Ne vlerësojmë se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në çdo rast ka detyrimin të përcaktojë pozitën juridike të magjistratit dhe të verifikojë ekzistencën e rrethanave procedurale që legjitimojnë efektet ligjore shkak-pasojë të paraqitjes së dorëheqjes, në raport me ecurinë e procesit të rivlerësimit, si elemente të domosdoshëm që diktojnë vendimmarrjen për pushimin apo jo të procesit.

18. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk duhet të ishte mjaftuar vetëm me arsyetimin se *"paraqitja e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit brenda afatit ligjor (sipas nenit 56) sjell si pasojë pushimin e procedurës së rivlerësimit, duke i dhënë këtij subjekti të drejtat e parashikuara në pikën 2 të nenit 56"* (fq. 2 e vendimit). Nga rrethanat e faktit, në raport me zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore, duhej të arsyetohej dhe argumentohej se shfaqja e njëanshme e vullnetit të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes brenda afatit ligjor, sipas nenit 56 të ligjit nr.84/2016, nuk mjafton që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të pushojë procedurën e rivlerësimit, pasi kjo dorëheqje duhet të kish ndjekur iter-in procedural të parashikuar në ligj, duke u administruar dhe formalizuar me vendimmarrje nga organi kompetent kushtetues, sipas ligjit nr.96/2016.

19. Sistemi i rivlerësimit kalimtar, referuar nenit 179/b të Kushtetutës, është ngritur dhe konceptuar si i tillë ku të gjithë gjyqtarët, përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë të KLD, duhet ti nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*. Ngritja e këtij sistemi synon garantimin e funksionit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë dhe rikthimin e besimit të publikut, e për këtë arsye, kusht i vetëm që subjektet e përmendura në pikën 3 dhe 4 të nenit 179/b të Kushtetutës, ku bën pjesë edhe znj Mirela Fana, të mund të qëndrojnë në sistemin e drejtësisë (*apo rifuten sipas prg.2 të pikës 4 të nenit 179/b¹*) është kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit.

20. Ligjvënësi ndjek të njëjtin qëllim në ligjin nr.96/2016, ku përcakton raportin midis statusit të magjistratit gjyqtarë dhe prokurorë, detyrës dhe procesit të rivlerësimit kalimtar. Neni 164, pika 1 gërma “b” parashikon se *“Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr.84/2016”*. Pra sipas Kushtetutës dhe ligjit, të gjithë magjistratët gëzojnë në mënyrë të kushtëzuar qëndrimin në detyrë dhe statusin e tyre, vijimi i të cilave lidhet me kalimin apo jo të procesit të rivlerësimit.

21. Dispozitat e sipërcituara rregullojnë rrjedhën normale të procesit të rivlerësimit, përfundimi i të cilit finalizohet nga institucionet e rivlerësimit kalimtar, duke vendosur mbi të drejtat dhe detyrimet e magjistratit në një nga format që parashikon neni 58/1² i ligjit nr.84/2016.

22. Por, ashtu siç ka ndodhur edhe në rastin objekt ankimi, kushtetutëbërësi (neni G i Aneksit të Kushtetutës) dhe ligjvënësi, në zbatim të dispozitës kushtetuese së mësipërme në kushtet specifike kohore të parashikuara në nenin 56 të ligjit nr.84/2016, ka parashikuar mundësinë që subjektet/magjistrat, të mos i nënshtrohen këtij procesi, në rast se japin dorëheqjen, duke mos vijuar të gëzojnë statusin e magjistratit.

23. Në gjykimin tonë, mundësia e parashikuar nga neni 56 i ligjit nr.84/2016, ku dorëheqja e subjektit pushon procesin, nuk nënkupton se vetëm shprehja e këtij vullneti të njëanshëm bëhet detyrues për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Nisur nga pasoja e rëndësishme ligjore mbi procesin (ndërprerje/pushim), Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në

¹ Procesit të rivlerësimit mund ti nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish gjyqtarët, ish prokurorët dhe ...

² Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit: a) konfirmimin në detyrë, b) pezullim nga detyra për një periudhë 1 vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit..c) shkarkimin nga detyra.

43

çdo rast ka detyrimin që të vlerësojë nëse mbi dorëheqjen e magjistratit është formalizuar vendimmarrja e organit kompetent kushtetues, ashtu siç ligji nr.96/2016 detyron.

24. Në këtë aspekt, me të drejtë, në të njëjtat rrethana juridike, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vlerësuar dhe deklaruar pushimin e procesit të rivlerësimit për një tjetër subjekt magjistrat/prokuror me vendimin nr. 11 datë 10.04.2018 dhe me dy vendimet e tjera për magjistratët/gjyqtarë, vendimi nr.8 datë 23.03.2018 dhe vendimi nr.10 datë 23.03.2018, vetëm pasi ka administruar vendimet e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si organe kompetente kushtetuese që i kanë dhënë *fuginë ligjore* aktit të dorëheqjes.


25. Vlen për t'u theksuar gjithashtu se dhënia e dorëheqjes nga detyra në kuptim të ligjit nr. 96/2016 gjen rregullim si në regjimin ligjor në situatë normaliteti ashtu edhe në periudhën kalimtare. Ligji nr.96/2016 deklarimin e aktit të dorëheqjes për magjistratët ia njeh vetëm dy organeve kushtetuese, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas kreut VIII, nenit 64 dhe 65 të ligjit, kompetencë e cila ushtrohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë apo Prokurori i Përgjithshëm për një periudhë kalimtare deri në konstituimin e plotë të dy organeve të reja kushtetuese (referuar nenit 160).

26. Lidhur me verifikimin dhe deklarimin e aktit të dorëheqjes nga organi përkatës i referohemi dhe paragrafit 16 të vendimit nr.40/2014 të Gjykatës Kushtetuese, e cila vazhdimisht ka reflektuar edhe standardet ndërkombëtare mbi statusin e gjyqtarit. Referuar një analize të harmonizuar të normave ligjore ndër të tjera kjo gjykatë thekson se "*statusi ligjor i gjyqtarëve duhet të jetë në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.... sistemi i garancive që gëzojnë gjyqtarët parashikohet edhe në dokumente ndërkombëtare...*", duke cituar kështu në interpretimin e saj dhe Kartën Europiane për Statusin e Gjyqtarit.³

27. Karta Europiane për statusin e gjyqtarëve përveç se përcakton rastet e përfundimit të ushtrimit të funksionit, ndër to edhe nëpërmjet dorëheqjes, përmbushjen e kushteve të parashikuara për përfundimin e ushtrimit të funksionit, e lidh me faktin se këto rrethana, **duhet**

³ Paragrafi 1.3 e Kartës "Lidhur me çdo vendim që ndikon në përzgjedhjen, rekrutimin, emërimin, përparimin në karrierë ose pushimin e funksioneve të një gjyqtari/eje, statuti parashikon **ndërhyrjen e një autoriteti të pavarur** nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, brenda të cilit të paktën gjysma e atyre që marrin pjesë të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre, duke ndjekur metoda që garantojnë përfaqësimin më të gjerë të gjyqësorit.

të verifikohen nga autoriteti kompetent, sipas së drejtës së brendshme, referuar paragrafit 1.3 të kartës.⁴



28. Në përfundim, Komisioneri Publik, duke theksuar domosdoshmërinë e formalizimit të dorëheqjes nga organet kompetente sipas ligjit nr.96/2016, vlerëson se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit si organ administrativ përgjegjës, me kompetenca të natyrës *quasi gjyqësore*, është autoriteti i posaçëm, i caktuar vetëm për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj magistratëve. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka përgjegjësinë që të ushtrojë veprimtarinë e tij brenda kësaj fushe, duke përmbushur të gjitha detyrimet që Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi e detyron.

29. Nisur nga qëllimi dhe rëndësia që paraqet procesi i rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk mund të vlerësojë dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit magistratit/gjyqtar për znj. Mirela Fana dhe të rregullojë pasojat juridike të kësaj dorëheqje në raport me procesin e rivlerësimit, në mungesë të administrimit dhe vlerësimit të vendimmarrjes të organit kompetent kushtetues, që shqyrton dorëheqjet e magistratëve sipas dispozitave të ligjit nr.96/2016.

III.B

30. Në kuadër të analizimit të bazës ligjore, arsyetimit dhe natyrës së dispozitivit të vendimit që merr institucioni përkatës i rivlerësimit në rastet e paraqitjes së dorëheqjes nga subjekti i rivlerësimit, jemi të mendimit se Kolegji i Posaçëm i Apelimit, edhe në rastin konkret, duhet të marr në analizë e të shprehet në lidhje me materializimin e pasqyrimin në vendimarrjen e institucioneve të rivlerësimit, të ndalimit të subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar për 15 vite në sistemin e drejtësisë, sipas pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

31. Në vendimin konkret, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe ndalimin që parashikon pika e dytë e kësaj dispozite, nuk e ka bërë pjesë as të bazës ligjore në të cilën është marrë vendimi dhe as të pjesës arsyetuese të tij.

⁴ Paragrafi 7. "Pushimi i funksioneve". 7.1. Një gjyqtar/e pushon përfundimisht së ushtruar funksionet nëpërmjet dorëheqjes, vërtetimit mjekësor të paaftësisë fizike, arritjes së kufirit të moshës, përfundimit të afatit të caktuar ligjor ose shkarkimit të shpallur në kuadrin e një procedure të tillë siç parashikohet në paragrafin 5.1 këtu më lart. 7.2. Ndodhja e njërit nga shkaqet e parashikuara në paragrafin 7.1 këtu më lart, përveç arritjes së kufirit të moshës ose përfundimi i një funksioni me afat të caktuar, **duhet të verifikohet nga autoriteti i përmendur në paragrafin 1.3 këtu më lart.**

45
32. Ndërkohë, konstatojmë se Kushtetuta dhe ligji nr.84/2016 nuk i njeh në mënyrë të shprehur të drejtën Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të vendosur si pjesë të dispozitivit të vendimit të saj parashikimin e pikës 2 të nenit G të Kushtetutës.

33. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit si organi i parë përgjegjës për rivlerësimin kalimtar, mund të shprehet vetëm për atë që ligji nr.84/2016 e lejon, pra sipas nenit 56 apo sipas nenit 58 pika 1.

34. Kompetencën e emërimit, rrjedhimisht edhe atë të ndalimit të emërimit për magjistratët, Kushtetuta ia njeh dy organeve të ngritura për këtë qëllim, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Nisur nga argumenti i trajtuar më lart në këtë ankim, mendojmë se pjesë e vendimmarrjes së këtyre organeve kushtetuese që deklarojnë mbarimin e mandatit të magjistratit për efekt të nenit G të Kushtetutës, do të duhej të ishte dhe ndalimi i parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni.

35. Në këtë kuptim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mund të shprehet vetëm mbi ecurinë e procesit të rivlerësimit, pra për rastin konkret për përfundimin e tij për shkak dorëheqje, por në zbatim të nenit G pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, do të duhej të kishte hetuar, identifikuar dhe arsyetuar dhe mbi aktin që materializon ndalimin e parashikuar nga paragrafi i dytë i kësaj dispozite kushtetuese, duke e bërë atë (nenin G) edhe pjesë të bazës ligjore të vendimit përkatës të Komisionit.

III.C

Mbi natyrën procedurale të vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

36. Siç vlerësuam edhe në rrethanat e çështjes, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në marrjen e vendimit nr.05, datë 23.03.2018, ka gjykuar mbi bazë dokumentesh, gjykim i cili *prima facie* nuk parashikohet shprehimisht nga neni 55 pika 5 dhe 6 e ligjit organik të saj, ku parashikohet se “...bisedimet për marrjen e vendimit.. zhvillohen me dyer të mbyllura në praninë e vëzhguesve ndërkombëtar dhe se vendimi i KPK shpallet në fund të seancës dëgjimore.”

37. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në rastin konkret ka vendosur vetëm mbi bazë dokumentesh, pa zhvilluar një seancë dëgjimore me praninë e subjekteve, që legjitimohen për t’u thirrur sipas parashikimeve të ligjit nr.84/2016.

Kjo lloj vendimmarrje mund të konsiderohet e drejtë dhe në respekt të parimit “për ekonomi në procedurat vendimmarrëse” dhe thjeshtimit të procedurave për çështje të cilat nuk ka

Florian Balla

nevojë tjetër e një seance dëgjimore apo ndërmarrjen e veprimeve të tjera shtesë në ndihmë të vendimmarrjes.

38. Për analogji me praktikën, referuar legjislacionit në fuqi, shqyrtimi i çështjeve mbi bazë dokumentesh/aktesh e gjejmë në ligjin nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”, ku në nenin 3 “Parimet e gjykimit administrativ” shprehet se “gjykata...shqyrton çështjen gojarisht në seancë gjyqësore ose mbi bazë aktesh shkresore në dhomë këshillimi”.

Megjithatë, ndryshe nga sa përmban neni 65/1 i ligjit nr.84/2016 për mënyrën e zhvillimit të procesit gjyqësor në Kolegjin e Apelit, në rastin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk gjejmë një dispozitë të posacme që të materializojë parimin e shprehur në nenin 3 të ligjit nr.49/2012.

IV. Kërkimi i ankimit

39. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit 66/2 i ligjit nr.84/2016, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, vendim nr.21/2010, paragrafi 16: “[...]16. Gjykata thekson se nenet 124, 132 dhe 145/2 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit (shih vendimin nr.5, datë 7.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese). Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese Gjykata thekson se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një ratio decidendi, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.06.2009). Nga kjo pikëpamje, Gjykata thekson se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vet Gjykata Kushtetuese.”, jemi të mendimit se përsa kohë në këtë ankim ngrihen shkaqe që lidhen me interpretimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese do t’i shërbente unifikimit të procedurave në të ardhmen në trajtimin e situatave të ngjashme.

Haris Balliu

47
47

40. Në këto kushte, në cilësinë e Komisionerit Publik, bazuar në dispozitën e shkronjës "c", pika 1 e nenit 66 të ligjit nr.84/2016, kërkoj:

- Prishjen e vendimit nr.05, datë 23.03.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Mirela Fana.

KOMISIONERI PUBLIK


Florian BALLHYSA